



Nr. 15 prot
Shkoder 12/03/18



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 16 Datë 07.03.2018

“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “GJONI KALIVAÇ” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim (miratim në parim) të subjektit “GJONI KALIVAÇ” sh.p.k., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “ **GJONI KALIVAÇ** ”sh.p.k., me administrator Z.GJOVALIN GJONI, për përdorim të burimit ujor, **Përroi i Vomesit**, degë e Lumit Gjadër , për prodhim energjie elektrike në Kalivaç, Njësia Administrative Ungrej , Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë. Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC EMANUELI do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes:	X – 44 00 526.5;	Y – 46 43 699;	Z – +389 m;
Koordinatat e godinës së centralit:	X – 43 99 159.8;	Y – 46 43 754;	Z - +220 m;
Koordinatat e pikës së shkarkimit:	X – 43 99 159.8;	Y – 46 43 754;	Z - +220 m;
Prurja mesatare vjetore e burimit:	Q mes = 0.4 m ³ /sek;		
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti:	Q llog = 0.6 m ³ /sek;		
Prurja ekologjike:	Q ekol = 0.034m ³ /sek;		
Prurja që shkarkohet:	Q = 0.6m ³ /sek.		

2- Autorizimi (miratimi në parim) i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike (të ruhet ekosistemi ujor duke mos cenuar segmentet ujore) .

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Çesk MILLJA

